

VENDIM
Nr. 25, datë 24.12.2012

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 3, DATË 25.6.2011 TË KOMISIONIT SHETETËROR PËR
NDIHMËN JURIDIKE “PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E
NDIHMËS JURIDIKE DHE DOKUMENTET QË DUHET T’I BASHKËNGJITEN FORMULARIT
TIP TË KËRKESËS”**

Në mbështetje të nenit 16 pika 1 të ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike

VENDOSI:

Në vendimin nr. 3, datë 25.6.2011 të Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, të bëhet kjo shtesë:

1. Në nenin 6 shtohet pika 5, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike nëpërmjet sekretariatit të tij siguron marrjen e dokumenteve të mësipërme për kërkuesit që janë pjesë e grupeve në nevojë.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Blegina Kodra